



**Hapet thirrja për mobilitete studentësh të UPT-së,
për semestrin e dytë të vitit akademik 2023 - 2024
në kuadër të Programit Erasmus+ KA107
në Politecnico di Torino (POLITO), Itali.**

Në kuadër bashkëpunimit midis Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Politecnico di Torino, publikohet thirrja për mobilitete për studentë të Universitetit Politeknik të Tiranës, në Politecnico di Torino.

Llojet e mobilitetit përfshijnë: Shkëmbimin e studentëve për studime.

Nivelet e mobilitetit për studentët: Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Bachelor ose Master të Universitetit Politeknik të Tiranës.

Fushat e studimit: Të gjitha degët

Kohëzgjatja e bursës: Semestri i II i vitit akademik 2023 - 2024, (shkurt – korrik 2024)

Numri total i studentëve: 4

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash e studimeve, deri në momentin e aplikimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj* (Italisht ose Anglisht);
- Dokumenti Learning Agreement**.



Key Action 1
- Mobility for learners and staff -

**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është: Italian-B1; English-B2.*

Për kriteret e kërkuara nga POLITO për gjuhën italiane ose angleze, ju lutemi klikoni te:
<https://www.polito.it/en/education/international-students/exchange-students/erasmus-and-bilateral-agreements/language-requirements>

Studenti duhet të plotësojnë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj. Preferohen: TOEFL iBT Certificate, Cambridge Certificate, IELTS Certificate.

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Mobility Plan”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në POLITO lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryeni në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” te seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, nga Drejtuesi i Departamentit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për të shkarkuar formatin e “Learning Agreement”, ju lutemi klikoni te:

[ANEKS 2 - Mobility-agreement-studies, student.pdf \(upt.al\)](#)

Për t’u njohur me listën e lëndëve të ofruara nga POLITO, ju lutemi klikoni te:
[International students | Politecnico di Torino \(polito.it\)](#)

Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT:

Deri më 10 tetor 2023, ora 12.00

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email:
rkodra@upt.al dhe abeqo@upt.al